

MODEL ORIENTUES. Ky është një model prokure e posaçme për regjistrimin fillestar si person fizik nga një shtetas i huaj. Të dhënat personale janë hequr dhe duhen plotësuar sipas rastit. Prokura hartohet dhe noterizohet pranë një noteri. Përgatitur nga AIPProfit Consult.

PROKURË E POSAÇME

(për regjistrim fillestar si person fizik, shtetas i huaj)

Sot, më datë [____], para meje Notere [EMËR MBIEMËR], në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore [____], anëtare [____], u paraqit personalisht:

(I/E) PËRFAQËSUAR:

[EMËR MBIEMËR], atësia [____], shtetas [SHTETËSIA], lindur në [____], me adresë [____], lindur më [____], madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID [____] me nr. [____] dhe mbajtës i lejes së qëndrimit shqiptar me nr. personal [____], i cili nuk e kupton gjuhën shqipe dhe për këtë, bazuar në nenin 100 të Ligjit 110/2018 datë 20.12.2018 “Për Noterinë” ku citohet “Aktet Noteriale hartohen në gjuhën shqipe, kur i interesuari, njëra ose të dyja palët nuk e dinë gjuhën shqipe, noteri kërkon ndihmën e një përkthyesi”, asistuar nga përkthyesi zyrtar i Ministrisë së Drejtësisë [EMËR MBIEMËR], mbajtëse e letërnjoftimit personal me nr. [____].

I lartpërmenduri me dëshirë të lirë, vullnet të plotë dhe të pavesuar, kërkoi nga unë Noterja redaktimin e kësaj prokure të posaçme në bazë të neneve nr. 64, 70 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 62, neni 99 i Ligjit 110/2018 “Për Noterinë”, si më poshtë vijon:

Unë i përfaqësuari i mësipërm, emëroj si përfaqësues të posaçëm z./znj. [EMËR MBIEMËR], atësia [____], amësia [____], shtetas shqiptar, lindur në [____] dhe banues në adresën [____], i datëlindjes [____], madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. [____] dhe nr. personal [____], të cilit i jap të drejta të plota që të më përfaqësojë me të gjitha tagret që njeh e lejon ligji, për të bërë aplikime pranë Organeve të Administratës Shtetërore (QKB-së, Bashki, Tatim Taksa, Sigurimet Shoqërore, Zyrat e Punës, Inspektoriati i Punës), të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për regjistrimin si Person Fizik, të kryejë të gjitha veprimet që kërkohen në organet përkatëse në emrin tim.

Përfaqësuesit i jap të drejtë e kompetencë që në emër dhe për llogari time të veprojë e të kryejë çdo veprim tjetër procedural që nuk është përmendur në këtë prokurë dhe që mund të dalë nga rrethanat në të cilat kryhen veprimet juridike për regjistrimin si person fizik.

Kjo prokurë e posaçme është e vlefshme nga momenti i nënshkrimit të saj dhe për një kohë të pacaktuar, deri në mbarimin e saj, me të drejtën e revokimit të saj në çdo kohë. I përfaqësuari deklaroi se: “Të gjitha veprimet e kryera nga përfaqësuesi im i posaçëm brenda tagrave të përcaktuara në këtë prokurë, në mbështetje të të drejtave që më njeh legjislacioni në fuqi në shtetin shqiptar, do t’i konsideroj të drejta e të mirëqena, sikur të ishin kryer prej vetë meje”.

Prokura e Posaçme u lexua me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë të përfaqësuarit nga përkthyesja znj. [EMËR MBIEMËR], përkthyes e miratuar nga Ministria e Drejtësisë, i cili e kuptoi përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehu vullnetin e tij të lirë e të plotë, u njoh dhe i kuptoi efektet e saj juridike, e nënshkroi atë rregullisht përpara meje Noteres.

I/E PËRFAQËSUARI

PËRKTHYESJA

NOTERJA

AlProfit Consult · alprofitconsult.al · +355 69 323 2349 · info@alprofitconsult.al